



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

DEGA VENDORE TIRANË

**NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.
2
TEL: 042255528**

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 8015

Nr. koleksioni: 3348

Tirane më 10/10/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2024053950245685799



KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI
(Shoqeria "ANEL& CO" Shpk)

Në Tiranë, sot, më datë 10 / 10 / 2024 (dy mijë e njëzet e katër), përpara meje Noter Julian Zhelegu, antar ne Dhomën Kombetare te Noterise, Dega Vendore Tiranë, me zyre ne adresën Rr. Pjeter Bogdani, nr. 13, K. I, Tiranë, përfaqësuar rregullisht me autorizim nga Zevendesnoteri Elsa Gurra, u paraqitën dhe kërkuan redaktimin e këtij akti palët e mëposhtme.

SHITESI:

Aleksandër Rogo, atësia Niko, amësia Figalia, shtetas Shqiptar, lindur në Gjirokastrë dhe banues në TIRANË, me adresë Bill Clinton 03910021; Nd. 6; H. 1; Farkë; Selitë; 1044; Tiranë, lindur më 31/01/1986, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 039424591 dhe nr. personal I60131067R;
(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Shitesi");

dhe

BLERESI:

Adrian Çela, atësia Surja, amësia Suzana, shtetas Shqiptar, lindur në Gjirokastrë dhe banues në Gjirokastrë, me adresë 18 Shtatori; Nd. 019; Gjirokastrë; Gjirokastrë; 6000; Gjirokastrë, lindur më 25/08/1968, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038231854 dhe nr. personal G80825022J;
(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Bleresi");

Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, Shitesi dhe Bleresi do të referohen veçmas si Palë/a dhe së bashku si Palët/t.

MEQENËSE:

- A. Shoqëria "ANEL& CO" sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria"), është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar e krijuar e që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Numër Unik Identifikimi L82505601P, me seli në Gjirokastrë, Rruga 18 Shtatori, Lagjia 18 Shtatori, godine 4- kateshe, kati i 2-te ne pasurie 15/4 ZK 8541, me kapital themeltar 7.805.591 leke (shtate milione e teteqind e pese mije e peseqind e nentedhjete e nje leke).
- A) Blerësi ka kërkuar te blejë nga Shitësi dhe ky i fundit dëshiron ti shesë Blerësit një kuote te kapitalit qe përfaqëson 100% (njëqind perqind) te kapitalit te Shoqërisë (ne vijim "**Kuota**") sipas parashikimeve të kësaj Kontrate.
- B) Kalimi i Kuotes sipas kesaj Kontrate eshte miratuar me vendimin bashkëlidhur te Ortakut te vetem te Shoqërisë "ANEL& CO" sh.p.k.
- C) Nga verifikimi i Regjistrimit te Barreve Siguruese, Kuota rezulton te jete e lire dhe e pa barrësuar.
- D) Ndermjet pales shitese ne cilesine e huamarresit dhe pales blerese ne cilesine e Huadhenesit, eshte nenshkruar Deklarata noteriale me nr. 25 rep., nr. 14 kol., date 09/01/201, notere Anisa Muskaj, nepermjet se ciles huadhenesi i ka dhene huamarresit shumen e huase ne vleren 1.800.000 leke (nje milione e teteqind mije leke) dhe Kontrata e huase me nr. 1286 rep., nr. 414 kol., date 11/02/2019, noter Julian Zhelegu, nepermjet se ciles huadhenesi i ka dhene huamarresit vleren e huase 5.000.000 leke (pese milione leke), shuma te cilat nuk kane likujduar nga huamarresi ende ne daten e nenshkrimtit te kesaj kontrate shitje kuotash.

PER SA ME SIPER, Palët ranë dakord për te lidhur këtë Kontrate Shitje Kuote.



NENI 1 OBJEKTI

- 1.1. Objekt i kësaj kontrate është kalimi i pronësisë së Kuotës nga Shitësi te Blerësi dhe fitimi i pronësisë mbi Kuotën që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë nga Blerësi, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Kontrate.

NENI 2 ÇMIMI DHE MENYRA E PAGESES

- 2.1. Çmimi i shitjes së Kuotës që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë është 6.800.000 LEKE (gjashtë milione e teteqind mijë leke).
- 2.2. Çmimi i shitjes gjendet i drejtë dhe i arsyeshëm dhe Palët garantojnë se me nënshkrimin e kësaj Kontrate nuk do të kenë asnjë pretendim në lidhje me çmimin e shitjes dhe mënyrën e pagesës.
- 2.3. Palët deklarojnë se shuma totale e çmimit të shitjes do të konsiderohet e likuiduar sipas detyrimit që pala shitese në cilësinë e huamarresit i detyrohet palet blerese në cilësinë e huadhenesit, sipas Deklaratës noteriale me nr. 25 rep., nr. 14 kol., date 09/01/2018, notere Anisa Muskaj dhe Kontrates së huase me nr. 1286 rep., nr. 414 kol., date 11/02/2019, noter Julian Zhelegu dhe nënshkrimi i kësaj kontrate shitje kuotash përben prove të plote të shlyerjes së detyrimit nga pala humarrese në favor të pales huadhenese dhe prove të plote të shlyerjes së çmimit të shitjes nga pala blerese në favor të pales shitese për shitjen e kuotës që përfaqëson 100 % të kapitalit të shoqërisë.

NENI 3 KALIMI I PRONËSISË MBI KUOTEN


- 3.1. Pronësia mbi Kuotën që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë kalon nga Shitësi te Blerësi menjëherë me lidhjen e kësaj Kontrate, e cila do të regjistrohet menjëherë në librat e Shoqërisë si dhe në Regjistrin Tregtar në QKB.
- 3.2. Palët konfirmojnë se struktura e zotërimit të kapitalit të Shoqërisë "ANEL& CO" shpk, me lidhjen e kësaj Kontrate dhe me depozitimin e saj në QKB, do të jete si vijon:
- **Z. Adrian Çela bëhet ortak i vetëm i Shoqërisë, zoterues i 1 kuote që përfaqëson 100% të kapitalit me vlerë prej 7.805.591 LEKE.**

NENI 4 KALIMI I PRONËSISË MBI KUOTEN

- 4.1 Pronësia mbi Kuotën do të kalojë nga Shitësi te Blerësi menjëherë me lidhjen e kësaj Kontrate dhe regjistrimin e saj pranë Qendres Kombëtare të Biznesit.

NENI 5 DEKLARATA DHE GARANCI

- 5.1 Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se:
- Shoqëria ekziston në mënyrë të ligjshme dhe kryen veprimtarinë tregtare sipas objektit të saj të deklaruar.
 - Shitësi është zotëruesi i vetëm i Kuotës dhe ai gëzon gjithë të drejtat e votës dhe çdo të drejtë tjetër që rrjedh nga Kuota dhe ka tagra të plota për të shitur Kuotën e zotëruar prej tij.
 - Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësi, nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumentet e tjera ligjore në të cilat Shitësi është palë.
 - Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se deklarimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë të vërteta, të sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit.
- 5.2 Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin se:



A2024053950245685799

- Blerësi ka tagra te plota për të blerë Kuotën sipas kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate.
- Blerësi deklaron e garanton se e njëj gjendjen ligjore, financiare dhe kontabël të Shoqërisë dhe se dëshiron të fitojë pronësinë mbi Kuotën pa rezerva të asnjë lloji.
- Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Blerësi, nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumentet e tjera ligjore në të cilat Blerësi është palë.
- Blerësi deklaron dhe garanton Shitësit se deklarimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë të vërteta, të sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit.

Neni 6 DISPOZITA TE FUNDIT

- 6.1 Kjo Kontrate hyn në fuqi me nënshkrimin e saj.
- 6.2 Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzolave apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të cenohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.
- 6.3 Kjo Kontrate përmban marrëveshjen e plote ndërmjet palëve në lidhje me objektin e përcaktuar këtu dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme, me gojë apo me shkrim, ndërmjet Palëve, në lidhje me objektin e kësaj Kontrate.
- 6.4 Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- 6.5 Çdo konflikt apo mosmarrëveshje që lidhet me hartimin, interpretimin apo zbatimin e kësaj Kontrate, që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet Palëve, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontrata u lidh në praninë dhe me miratimin e bashkëshortes së shitësit, **Znj. Jorjana Kristo**, atësia Spiro, amësia Marika, shtetase Shqiptare, lindur në Sarandë dhe banuese në TIRANË, me adresë Bill Clinton 03910021; Nd. 6; H. 1; Farkë; Selitë; 1044; Tiranë, lindur më 20/02/1987, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035256770 dhe nr. personal I75220074F, e cila deklaroi se jep pëlqimin dhe miratimin e saj të plote për përmbushjen dhe ekzekutimin e kontratës sipas të gjithë kushteve dhe afateve të mësipërme.

Kontrata u redaktua nga unë Noteri sipas kërkesës së palëve në gjuhën shqipe dhe në 4 kopje origjinale, dhe pasi iu lexua dhe iu shpjegua palëve nga unë noteri me zë të lartë dhe të qartë u kuptua dhe u pranua prej palëve, u nënshkrua rregullisht dhe pa vërejtje prej palëve në praninë time dhe unë, noteri, e vërtetoj sipas ligjit dhe për të gjithë efektet e tij dhe e nënshkruaj rregullisht. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

SHITES

Aleksander Rogo

Aleksander Rogo
ANEL & CO
SH.P.K.
TIRANË
ID NOIS : L 82505601 P
TIRANË - ALBANIA

MIRATUESI

Jorjana Kristo

Jorjana Kristo

BLERESI

Adrian Çela

Adrian Çela

NOTERI

Julian Zhelegu

*Përfaqësuar me autoritetin
Zëvendësnoter
Elsa Shkëmbi*